



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.195, datë 12.07.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”


Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59, pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin e përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Genci Mane**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
2. Zoti Genci Mane, do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nga data 10.09.2022 - 09.12.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, zoti Mane do të paguhet me pagën e pozicionit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Genci Mane, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 12.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla
ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi


ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurhan Sëiti




ANËTAR
Eloida Coxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Mirela Bogdani